



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:087036

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05492122

C.nr.2023:087037

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL, gjyqtarja Kreshnike Zymberi Beqiri si dhe bashkëpunëtoren profesionale Ilirjana Hashani, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëseve B.T., E. I., S. B. dhe Rr. F. që të gjithë me vendbanim ne Komunën e Shtimes të cilët i përfaqëson me autorizim av. Faton Neziraj nga Shtimja, e paraqitur kundër të paditurës Komuna Shtimes - Drejtoria e Arsimit, në çështjen juridike kompensim i të ardhurave në emër të inflacionit, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 22 mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

*-pa shqyrtim kryesor të çështjes-*

- I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëseve B.T.E. I., S. B. dhe R.F., e ushtruar kundër të paditurës Komuna Shtime- Drejtoria e Arsimit, si e bazuar.
- II. DETYROHET e paditura Komuna Shtimes - Drejtoria e Arsimit, që paditëseve në bazë të rritjes së shkallës së inflacionit si pagesë shtesë në pagën bazë, të u kompensoj shuma si në vijim;
  1. Paditësit B. T. për periudhën kohore për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2020 për shkallen e inflacionit 0.2% shumën prej 6.60€, për muajt Janar- Dhjetor 2021 të vitit 2021 për shkallen e inflacionit 3.4% shumën prej 112.32€ si dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 për shkallen e inflacionit 11.6% shumën prej 341.67€, apo në shumë të përgjithshme prej 460.59€ (katërqind e gjashtëdhjetë euro e pesëdhjetë e nëntë euro).

2. Padi tëses E. I.për periudhën kohore për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2020 për shkallen e inflacionit 0.2% shumën prej 6.50€, për muajt Janar- Dhjetor 2021 të vitit 2021 për shkallen e inflacionit 3.4% shumën prej 111.33€ si dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 për shkallen e inflacionit 11.6% shumën prej 338.68€, apo në shumë të përgjithshme prej 456.51€ (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e një cent).
3. Padi tëses S. B.për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2020 për shkallen e inflacionit 0.2% shumën prej 9.72€, për muajt Janar- Dhjetor 2021 të vitit 2021 për shkallen e inflacionit 3.4% shumën prej 165.24€ si dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 për shkallen e inflacionit 11.6% shumën prej 502.68€, apo në shumë të përgjithshme prej 667.64€ (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro gjashtëdhjetë e katër cent).
4. Padi tëses Rr. F.për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2020 për shkallen e inflacionit 0.2% shumën prej 6.69€, për muajt Janar- Dhjetor 2021 të vitit 2021 për shkallen e inflacionit 3.4% shumën prej 113.40€ si dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 për shkallen e inflacionit 11.6% shumën prej 346.40€, apo në shumë të përgjithshme prej 466.95€ (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e nëntëdhjetë e pesë cent).

Të gjitha këto secilit padi tës veç e veç të ua paguaj me kamat ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (datë 12.04.2023) deri përmbushjen definitive, në afat prej 7 dite nga plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarimit të detyrueshëm

III. OBLIGOHEN padi tësit që në mënyrë solidare të paguajë taksën gjyqësore shtesë në shumën prej 30.<sup>00</sup> € dhe këtë ta bëjë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

IV. OBLIGOHET e paditura, që padi tësve të ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 290.00 € , në afat prej 7 dite nga plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre me date 12.04.2023 pranë kësaj gjykate kan parashtruar padi me të cilën kan kërkuar kompensimin mbi bazën juridike te inflacionit si dhe kan bërë precizimin e saj ashtu që për paditësin B. T.ka kërkuar kompensimin për inflacion për vitin 2020 nga paga baze 275.30 euro me shkallë të inflacionit për 0.2 % ,per vitin 2021 nga paga bazë 275.30 euro, me shkallë të inflacionit për 3.4 %, për vitin 2022, 11.6%, për periudhën nga Janari deri më datën 21.11.2022 në shumën e përgjithshme prej 460.59 €, paditësit E. I. kompensimin për inflacion për vitin 2020 nga paga baze 272.88 euro me shkallë të inflacionit për 0.2 % ,per vitin 2021 nga paga bazë 272.88 euro, me shkallë të inflacionit për 3.4 %, për vitin 2022, 11.6%, për periudhën nga Janari deri më datën 21.11.2022 në shumën e përgjithshme prej 456.51 €, paditësit S.B. kompensimin për inflacion për vitin 2020 nga paga baze 405.00 euro me shkallë të inflacionit për 0.2 % ,per vitin 2021 nga paga bazë 405.00 euro, me shkallë të inflacionit për 3.4 %, për vitin 2022, 11.6%, për periudhën nga Janari deri më datën 21.11.2022 në shumën e përgjithshme prej 667.64 €, paditësit Rr.F.kompensimin për inflacion për vitin 2020 nga paga baze 279.10 euro me shkallë të inflacionit për 0.2 % ,per vitin 2021 nga paga bazë 279.10 euro, me shkallë të inflacionit për 3.4 %, për vitin 2022, 11.6%, për periudhën nga Janari deri më datën 21.11.2022 në shumën e përgjithshme prej 466.95 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita a marrjes se vendimit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëse është e pabazuar pasi që kontrata kolektive e nënshkruar më dt. 17.04.2017 nuk është më në fuqi ndërsa sipas ligjit të punës kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar. Kontrata kolektive ka paraparë që shkalla e inflacionit sipas entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e saj të futet në pagë dhe kompetente për llogaritjen dhe përfshirjen e inflacionit në page është enti i Statistikave të Kosovës. I ka propozuar gjykatës që të refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitivin e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitivë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton*

*se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.*

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU ‘...’ në fshatin .... Komuna ....., e që ky fakt gjen edhe mbështetje në bazë tek kontratat e punës dhe si dhe nuk është kontestuese se paditësit gjenden në listën e pagave dhe kanë pagat bazë të përshkruara si më lart .

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigjen në padi, Gjykata ka vlerësuar se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruara nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 respektivisht me nenin 48 të këtyre kontratave është përcaktuar se këto kontrata hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se me Kontratën Kolektive të datës 18.04.2017 respektivisht atë të datës 22.01.2021, në nenin 35.10 thuhet “Për çdo vit përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, ku gjykata bazuar në listat e pagës nuk rezulton se shkalla e inflacionit është futur në pagë, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadisë në lidhje me shkallën e inflacionit e ka bazuar në të dhëna zyrtare të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës përmes web faqes zyrtare.

Bazuar në këto të dhëna rezulton se shkalla mesatarja vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ua ka aprovuar paditësve kompensimin për inflacion për vitin 2020 0.2% ,2021, 3.4%, për vitin 2022 11.6%, nga Janari deri më 21.11.2022, shuma për paditësin e pare është 460.59 euro, për paditësin e dyte është 456.51 euro, per paditësin e trete shuma prej 667.64 euro si dhe për paditësin e katërt shuma prej 466.95 euro ,ndërsa shuma e përgjithshme është 2,051.69 euro, ashtu siç janë cekur shumat si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, si të bazuara.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratave Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësve është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditëseve tua paguaj shumat e specifikuar në pikën II të dispozitivit

Gjykata deri te ky qëndrim ka ardhur duke u bazuar edhe me nenin 2 të LMD-së autonomia e vullnetit ku thuhet “Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, ti rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre” që në rastin konkretë palët me vullnetin e tyre janë pajtuar që sa i përket çështjes së inflacionit duhet të përcillet, respektivisht të përfundoj viti kalendarik e tek atëherë të merret për bazë mesatarja, e jo për çdo muaj apo për një periudhë të caktuar të vitit pa përfunduar viti kalendarik.

Andaj meqenëse ashtu siç është rregulluar e paditura ka pasur detyrim që paditësve t’ia shtoj në pagë shkallën e inflacionit të cilën gjë nuk e ka bërë për periudhën kontestuese, në njërën anë kurse në anën tjetër edhe paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017, dhe asaj të datës 22.01.2021 sa i përket mjeteve monetare në emër të shkallës së përqindjes së inflacionit dhe nenit 8 të LMD-së, ku thuhet se “Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditësit. Në rastin konkret gjykata i zbatoj dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L/212 ku shprehimisht thuhet “Marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në marrëveshje te tillë kolektive”.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së,

duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 19.07.2022 bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 260 euro për përpilimin e padisë si dhe për taksën gjyqësore shumë prej 30 euro, gjithsej shumë prej 290.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ  
C.nr 2023:087037, me datë 22 mars 2023

Gjyqtarja  
Kreshnike Zymberi Beqiri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.